



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Prilipi / Predato Receipt / Delivery	10.02.23	Viti god. Year	2023
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SUMSHUK/1680/2023			113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.30/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.30/2023 të datës 10.01.2023 e parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 10.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.30/2023 të datës 10.01.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.066/2022 të datës 04.07.2022 në pozitën "Drejtor i Qendrës së Paraburgimit" në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, me datën 10.01.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 100/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD/053/13/12/2022 të datës 13.12.2022 lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore ndaj tij me 50% te pagës, me pretendimet ankimore për shkak të pa arsyeshmërisë dhe përshtatshmërisë faktike dhe ligjore te masës se shqiptuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 16.01.2023, përmes shkresës me numër protokollit 388/2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datën 20.01.2023, përmes

shkresës me numër protokollit 601/2023 ka përcjellë përgjigjen në ankesën e ankuesit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 100/2023 të datës 10.01.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD/053/13/12/2022 të datës 13.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.01.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 20.01.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankuesit me numër AE.Nr.066/2022 të datës 04.07.2022; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit të datës 13.12.2022; Vendimin me numër KD.nr.053/2022 të datës 10.01.2022; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 01.08.2014; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 26.01.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019 të datës 31.12.2020; Vendimin me numër KD.nr.053/2022 të datës 23.01.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Shkresën zyrtare të datës 09.02.2023 lidhur me tërheqjen e ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit **është bërë i pamundur, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 10.01.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datën 09.02.2023, ka parashtruar shkresën zyrtare me numër të protokollit 1653/2023, me të cilën ka deklaruar se e tërheq ankesën e datës 10.01.2023 me arsyetimin se kanë përfunduar hetimet lidhur me rastin e ndodhur të datës 13.12.2022 dhe ndryshimin e vendimit të pezullimit nga puna. Kolegji i Këshillit në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : *“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, andaj në këtë kuptim, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.30/2023, datë 10.02.2023.

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.